



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E FINANCIMIT TË ARSIMIT TË LARTË
BORDI DREJTUES**

Nr. 9 Prot.

Tiranë, më 05.01.2026

VENDIM

Nr. 01 Datë 05.01.2026

PËR

**“MIRATIMIN E PËRLLOGARITJES SË FONDIT TË GRANTIT TË MËSIMDHËNIES
PËR INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR PERIUdhËN
BUXHETORE 2026-2028”**

Bordi Drejtues i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, mbështetur në nenin 11 dhe nenin 112, të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, gërmën “c” dhe “ç”, të pikës 6, të Vendimit nr.397, datë 3.5.2017 të Këshillit të Ministrave “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL)”, Vendimin nr.75, datë 12.02.20218 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, i ndryshuar, Udhëzimin e Përbashkët të MAS dhe MFE nr.20 datë 20.09.2019 “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor”, i ndryshuar, në zbatim të ligjit 87/2025 “Për buxhetin 2026”, dhe Rregullores së Brendshme të Bordit Drejtues të AKFAL,

VENDOSI:

1. Miratimin e përlllogaritjes së fondit për institucionet dhe fondin e mbështetjes studentore, pjesë e grantit të mësimdhënies, për institucionet publike të arsimit të lartë, për periudhën buxhetore 2026-2028, sipas 3 (tre) tabelave bahkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Nga fondi grant i mësimdhënies për Universitetin Bujqësor të Tiranës është përlllogaritur edhe fondi prej 50,000,000 lekë, në kuadër të projektit BOKU.
3. Nga fondi grant i mësimdhënies për Universitetin Politeknik të Tiranës është përlllogaritur edhe fondi prej 5,000,000 lekë në kuadër të projektit me UTC-Francë.
4. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit.
5. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI DREJTUES

KRYETARI
Erzen TOLA

ANËTARËT

Besmir BEJA

Artan HOXHA

Agron KASA

Spiro BRUMBULLI